

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pesëmbëdhjetë e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 29.05. 2023

Në mbledhje morën pjesë:

- 1.Mirheta Garçeviq, kryetare;
- 2.Veron Halili, anëtar;
- 3.Ivana Krushçiq, anëtare;
- 4.Admir Adrovic, anëtar;
- 5.Tripo Matijevis, anëtar

Frashër Selimaj, anëtar nuk mori pjesë në mbledhje për shkaqe të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë e kishte njoftuar kryetaren e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe IvanLekoviq, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutim dhe deklaram lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e katërmëdhjetë e rregullt e Komisionit;
2. Diskutim për përgjigjen e Këshillit të RTMZ për iniciativat e dërguara, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të menaxhmentit të RTMZ, zotëri Damir Ramoviq;
3. Miratimi i Iniciativës që në planin programor dhe të produksionit të Portalit të RTMZ të përfshihen edhe përmbajtjet e Redaksisë së programit të pakicave;
4. Të ndryshme

I

Procesverbali nga mbledhja e katërmëdhjetë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (5 vota PËR)

II

Mirheta Garçeviq e përshëndeti Redaktorin e programit të parë Damir Ramoviq duke e falënderuar për praninë e tij. Pastaj lexoi përmbajtjen e iniciativës së dërguar në Këshillin e RTMZ nga 29 marsi 2023, që kishte të bënte në kthimin në gjendjen e mëparshme të terminëve të emisioneve, “Mosotovi” dhe “Savore”. Për këtë, janë të mendimit se këto janë të vetmet dy emisione të cilat merren me afirmimin dhe mbrojtjen e të gjithë popujve pakicë dhe bashkësive tjera, përveç shqiptarëve, prandaj ndryshimin e terminëve nga e shtuna dhe e diela në ora 18,30 në të hënë dhe të martë në ora 11,15, nuk e shohin të mirë nga shumë aspekte.

Damir Ramoviq u përgjigj se termini i mëparshëm ishte në kohën e emetimit të njërit nga emisioneve më të shikuara në vend, prandaj konsideron se ndryshimi im terminit është zgjidhje e mirë, që e arsyetoi me të dhëna të caktuara për numrin e shikuesve të vet emisioneve dhe reprizave të tyre.

Tripo Matijević kërkoj që tu dorëzohen të dhënat nga termini i mëparshëm dhe aktuale, në çgjë Damir Ramović u përgjigj se nuk posedon me këto të dhëna por duke krahasuar emisioni, “Dnevna soba”, e cila emetohet çdo ditë, shënohet numri më i madh i shikuesve. Gjithashtu theksoi se me ndryshimin e terminit është rritur shikueshmëria edhe programi ditor i të shtunës, sepse janë futur disa emisione me karakter zbavitës që kanë kontribuar në këtë drejtim.

Mirehta Garçević theksoi se pas analizës të cilën e paraqiti Damir Ramović, vendimin për ndryshimin e terminit e konsideron të drejtë.

Tripo Matijević kërkoj që në të ardhmen të njoftohet Komisioni në kohë për qëllimet e redaktimit pa marrë parasysh në obligimet ekzistuese, që të mos ketë nevojë të kërkohet arsyetim dhe sqarime shtesë. Pas, Admir Adroviq pyeti nëse planifikohen emisione të reja të cilat u kushtohen popujve pakicë dhe bashkësive tjera. Damir Ramović paraqiti të dhënat se planifikohet emetimi i Ditarit gjysmë ore në gjuhën shqipe, ditëve të punës në Programin e dytë ose në Kanalën parlamentar, emisioni në gjuhën shqipe me karakter rajonal, që do të emetohej të mërkurave si dhe emisioni i cili do ti kushtohej pjesëtarëve të popujve kroat dhe boshnjak, që do të lidhej me qendrat rajonale të këtyre shteteve.

Mirheta Garçević theksoi se në plani programor e produksionit për vitin 2022 ishte paraparë emetimi i disa emisioneve të caktuara, por të cilat nuk u realizuan, kurse shkaqet për mosemitim të tyre ajo i konsideron si të paarsyeshme dhe të papranueshme. Damir Ramović theksoi se redaksia i ka të gjitha kushtet e nevojshme për punë dhe se puna e të punësuarve në këtë redaksi do të duhej të jetë shumë më i mirë. Ai poashtu tha se ekziston problemi i gjetjes së kuadrove nga bashkësia rome. Tripo Matijević pyeti nëse ekziston sistemi i rezervimit të zyrës, në mënyrë që të punësuarit të njoftohen se kur mund ta përdorin atë ose është paraparë ndonjë mënyrë tjetër. Damir Ramović u përgjigj se nuk ekziston por ekzistojnë hapësirat e Redaksisë në gjuhën shqipe të cilat mund të shfrytëzohen dhe janë të lira çdo ditë deri në ora 15, sepse kështu është organizuar puna dhe se nuk ka pengesa që edhe ato mund të përdoren nëse është nevoja.

Tripo Matijević pastaj tha se do të duhej që kjo informatë tu dërgohet të punësuarve në redaksinë për popujt tjerë pakicë dhe bashkësive tjera, dhe se fillimisht do të duhej të rregullohet hapësira primare për punë.

Admir Adroviq pyeti nëse është në plan hapja e studios në Ulqin. Damir Ramović u përgjigj pozitivisht, si edhe në Bijello Pole e Herceg Novi.

Në pyetjen e Tripo Matijević lidhur me mundësinë e angazhimit të korrespondentëve nga këto qytete, Damir Ramović u përgjigj se është duke u punuar në integrimin e korrespondentëve për Radio dhe Televizion, e që deri tani është treguar e mirë, por mbetet i hapur për këtë ide nëse është e mundur në pajtim me aktin e sistematizimit.

III

Duke pasur parasysh se Damir Ramović i njoftoi anëtarët e Komisionit se reprizat e emisioneve, “Mosotovi” dhe “Savore” emetohen në Portalin e RTMZ, u konstatua se nuk është nevoja për dërgimin e iniciativës në Këshillin e RTMZ si dhe të diskutohet për pikën e propozuar të rendit të ditës.

IV

Në kuadër të pikës, Të ndryshme, nuk kishte tema për diskutim.

PROCESVERBALIN E PUNOI
Ivan Leković

KRYETARJA E KOMISIONIT
Mirheta Garçević